



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/ L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 qershor 2008), të dispozitave të nenit 30 të Ligjit nr. 03/L-175, për borxhet publike dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 07.11.2019, merr këtë

V E N D I M

Neni 1

AUTORIZOHET marrja e borxhit nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për përmirësimin e efijencës së energjisë së ndërtesave publike.

Neni 2

Borxhi i cekur në pikën I të këtij vendimi, do të jetë deri në vlerën prej 5,000,000.00 €, me afat 10-vjeçar për shlyerjen e borxhit (3 vjet periudhë mospagimi).

Neni 3

Pjesë e këtij vendimi është edhe marrëveshja e parafinancimit, e lidhur me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe dokumenti mbi termat dhe kushtet e kredisë/borxhit.

Neni 4

Ky borxh i nënshtrohet miratimit paraprak nga Ministria e Financave.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-421/01-275223/19, më 08.11.2019



KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta